
ARCHIVAL POST

Mit’hat Frashëri (1880 – 1949)



Emërtimi i institucionit Arkiva Zëdhënëse Viti 1945
Emërtimi i sektorit Dosjeve

D O S J A Nr. 5

TITULLI I DOSJES

Dosje - Fashkulle me dokumenta nëb. veprimtarin[illegible] tradhëtare të kriminelit Lefë Mihal Fra-shërit gjat okupacionit e në arrati.

Afati i ruajtjes
Shtia e fletëve 221

Ka filluar më 1943
Ka mbaruar më 1944
Numuri rendor i inventarit

AIDSSH

SECTION

Historical figures

PERIOD

1943 - 1949

Mit’hat Frashëri was born on March 25, 1880, in Ioannina. He was the son of Abdyl Frashëri, one of the leaders of the League of Prizren, and the nephew of Sami and Naim Frashëri, prominent figures of the Albanian National Renaissance. He was educated in Istanbul, where he also became involved in the Ottoman administration. His engagement in Albanian national affairs was particularly notable at the Congress of Manastir in 1908, where he was elected Chairman of the Congress and Vice-Chairman of the Alphabet Commission. The Congress represented a pivotal moment in the process of standardizing the Albanian alphabet, under the leadership of Gjergj Fishta as chairman of the relevant commission. In 1944, amid the Second World War and political changes in Albania, he left the country and settled in the United States. Mit’hat Frashëri died on October 3, 1949, in New York, following a heart attack.


CONTENT #1

Section 1

In the archival documents, File No. 5 provides a concise overview of Mit’hat Frashëri’s activities during and after the Second World War. The file includes documents identifying him as having been involved with the occupation authorities and describing his activities while in exile, as well as his involvement in the organization and leadership of the Balli Kombëtar. The file also contains his will, in which he states that his estate is to be used for the establishment of an institution dedicated to Albanological studies. The material further includes a poem written by Bardhyl Pogoni in 1945, a 1949 report concerning a meeting in Rome between Mit’hat Frashëri and Abaz Kupi, and a Balli Kombëtar notice announcing his death. The file concludes with the archival record documenting the closure and filing of his records following Mit’hat Frashëri’s death.

Media 1

MEDIA ITEMS #1



(28)

Unë, Mihat Frashëri, tue qënë në shëndet trupor të plotë, po bënj këtë testament, duke ushqyerë shpresën se pas vdekjes' s' ime do t' ekzekutohetë pikërisht vullneti që dëftenj këtu:

1) Çë kam pasuri të tundëshme ose të patundëshme, libra, mobilla, kartë, plaçka etj. i lë për krijimin' e një " INSTITUT ALBANOLOGJIJE ", që të jetë një qëndër' e studimevet shqipëtare, të mprojë, të ahvilloj̈ë, të qëndrëshojë dhe të udhëheqnjë studimetë që përkasin Shqipërinë dhe Shq'pëtarët.

2) Dua që nga biblioteka private ime të mos qkëputetë gjë; të gjitha librat të rrinë tok.


3) Mbeturinat' që kam nga im atë dhe nga unjgjërit, dhe që set formojnë muzenë t'ime familiare, dëshërenj që të ruhenë prapë në formë të një muzeje së vogëlë, brënda në Institut.

4) Në paça të holla, në shtëpi, më no një bankë ose hua për të mbledhurë, duke ubashkuarë me sumën që do mirretë nga shitja e Librarisë, dua që të përdorenë të gjitha së bashku:

A) për të bërë spenximet e parë e një godije (shtëpie) e cila të shërbejë si INSTITUT ALBANOLOGJIJE, një godi e mjaftë për të nxënë bibliotekënë dhe për zyrratë. Dëshira e ime është që kjo shtëpi të jetë mjaft' e gjerë sa për të pasur një ose dy oda ku të mun-

AIDSSH

MEDIA ITEMS #2



(29)

fqe e dytë

oda ku të mundin të bujten dhe të rrinë mysafirë studimtarët albanologë të huajë që vijnë së jashtmi.

Do të donja edhe që INSTITUTI të munt të goditetë në një mënyrë që të jetë lark qdo godije tjatrë dhe të mos ketë rrëzik zjari.

B) në qoftë se, në vdekjet t' ime, kam mundurë të godit ve ' no një shtëpi, INSTITUTI do të instalohete ie. Atëhere të hollat e produktuara, si them më siprë, do të vihenë në një bankë të sigurtë, dhe interesi i tyre do të përdoretë për qëllimin e INSTITUTIT, sidomos për të shtypurë libra ose për të ankurajuarë botimin e tyre.


5) Librarija ime dëshërenj që të shi'iet ashtu si është, e tërë bashkë, jo copa copa, dhe, në qoftë e mundurë të mbanjë emërin që i kam dhënë unë.

6) Libravet të INSTITUTIT t' u vihetë vulla ime " Biblioteka Lume Skëndo 1897 " dhe t' u njgjitetë Ex-libris. Vula do të gjendetë në tryezën' t' ime në shtëpi e gatijtë, kur se ex-libris është vetëm një skicë bërë prej Hyshref Frashërit.

7) Instituti do të jetë nënë këqyrjen e një Komisieni, bërë prej Drejtorit të Bibliotekës' së Shtetit në Tiranë (Bibliotekë Kombëtare), prej Kryetarit të Bashkië' së Tiranësë dhe prej një funksionari të Ministris' s' Arsi-

AIDSSH

MEDIA ITEMS #3



faqe e tretë (30)

tris' s' Arsimit.

8) Për të xbatuarë testamentin t'im dhe për të ngrehurit e Institutit lë si të ngarkuarë prej meje këta Zoterinj: Niazi Tirana, Sotir Kolea, Dimitri Berati, Mehdi Frashëri, Edhem Fuad Frashëri. Zotit Niazi Tirana i jap barrënë që të kujdesetë edhe si një notabl i Kryeqytetit.


9) Në qoftë se një prej këtyre zotërinjve gjendet absent për një ose tjatrë shkak, në kohët të vdekjes' s' ime, atëhere ata që gjendenë janë të ngarkuarë të zgjedhin aqë anëtarë sa mungojnë prej numurit që shënonj unë.

10) Ngarkonj prapë Baban e Teqes' së Frashërit dhe Kryetarin e Bashkis' së Frashërit të kenë mirësinë dhe të kujdesenë për mbarimin' e dëshirës' s' ime që shtronj në këtë testament, do në fillesë të punësë, do edhe çdo mot duke kërkuarë që të betohetë veprimi dhe bilançoja e Institutit.

11) Ushqenj besimin e plotë se kjo dëshirë ime do të xbatohetë besnikërisht prej pasanikëvet të mij ndë gjithë shekujt që do të vijnë dhe lutja ime drejtuarë fuqis' së madhe që tani s' e kupëtojmë dot, do të jetë të kenë gjithë Shqipëtarët idealin e përparimit dhe të maltësimit të Kombit, që Shqiptarizma të bëhetë një dëshirë dhe një konviktim i thellë, dhe që çdokush të kupëtojë se e mira e Kombit është dhe e mira jenë priva-

AIDSSH

MEDIA ITEMS #4



faqe e katërtë (31)

jenë private, se nderi dhe lavdi i Shqipëtarëvet të gjithë është edhe nderi dhe lavdi ynë personal.

12) Nukë di ku do të vendoset Instituti; po, në qoftë se goditetë pakëzë jashtë qytetit, do të donja që varri im të jetë në një cep të kopshtit, më të mënjgjërë duke hyrë nga porta e rrugësë; mbi këtë varr dua një copë gur të math dhe një qiparis; Më duketë sikur do të jem ruajtësi i Institutit, sikur do të marr edhe unë një pjesë pasjetore në gjëllimin e tij.

Me këto dëshira dhe shpresa po e nënshkronj me dorën t'ime këtë testament.

AIDSSH

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 2

MEDIA ITEMS #1



FLAMURIT

NGA LUFTA E MË LUFTË PËR LIRI
"BALLI KOMBËTAR"

Që larg, në mërgim
në pluhur të vështroj
Flamur i grisur
i Dheut t'im.

E sot andej valon përpjetë
mbi thik'e bajonet,
Ku dhé pikon ahí gjak vëllaj

. . .Qaj Zemr'e KOMBIT qaj. . .

Flamur i math u-ngrite, krenar mbi brigje Vlore,
Ku kûthi zemr'e kombit në luft'e në fitore
dhe ja tani përplaset po rrahj'e valës s'ate
mes thikash që të grisin kremarinë që pate,
dhe kur Dëshmorët bijen në pluhur nga vëllaj,
Ti fshin nër bajoneta ahí gjakun e pa faj . . .

Heu! Ndërzjej'e kombit tek Ty sot mbeti vetëm,
kur malesh gjemon kënga: SHQIPTAR'ne qem'e mbetëmi's
SHQIPTAS: tha Safet Butka, SHQIPTAR tha Kol Tromara!
SHQIPTAR po Jup Kazazi • MË FLAMUR • thot' • përpara s!

Për Ty FLAMUR i Vlorës, për Ty FLAMUR i Krujës,
ne shkrojtëm Shtatë Prillin dhe gjak'n e Kapter Mujës.

Dhe sot at'e mbi gurë
përkulen ca flamure
dhe Zhgsha arratiset
me Flamurin që griset
te Shpell'e Dragobisë
— Katakomb'e SHQIPËRIS —
. kur pokit' andej, pa faj
pikon ahí gjak vëllaj . . .

. . Qaj Zemr'e Kombit, çaj . . .

Askurt' jo nuk përkulet
të zbres andej FLAMURI
që krenarisht e mbajti
me Vdekje Bajram Curri . . .
As sot jo, kurr nuk ulet!
Atje mbi gur'e gjeni :
E mban Abaz Ermeni

Që larg, nëmërgim
të vështroj në pluh'r
i grisur FLAMUR
i Dheut t'im . .

E sot andej valon përpjetë
mbi thik'e bajonetë . . .

. . . pikon ahí gjak i shkretë . . .

Malesh pikon përpjetë
malesh gjëmon
me sulm e jete'
një këng'e FLAMURIT të ri:
e FLAMUR që s'i u - përkule
askujt në Skllaveri. . . .

Romë, 28 Nëndor 1945

BARDHYL POGONI

ASSH

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 3

MEDIA ITEMS #1



INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 4

MEDIA ITEMS #1



ZI KOMBETARE!

201

MIDHAT FRASHERI ndrroi jetë!

MIDHAT FRASHERI, Kryetari i Nacionalizëmës Shqiptare në luftë e në paqë, sherbetori i Shqipnise Etnike dhe i Demokratise Shqiptare ndrroi jetë ne Shtetet e Bashkueme t' Amerikes.

MIDHAT FRASHERI, krijues i Alfabetit Shqip, nderturs i ghubes qe ne sot flasim e pregatiti popullin Shqiptar te jete zot i vehtvehtes. Veprat e ndershme te Midhat Frascheri shkaktuen qe Shqipnija dhe Shqiptaret te njohin ne personen e TIJ BIRIN E PAVDEKSHEM TE FAMIJES FRASHERJOTE. Ay jetoje vetem per Shqipni dhe Shqiptarë. Ay e quente vehten, dhe ciilin do Shqiptar qe punonte per Shqipni, sherbetor ne sherbim t'Atdheut.

MIDHAT FRASHERI mbetet per né nji Gandh i madh né nji popull te v.. el. Syrë e tije mbusheshin me lolë sa here që i permendesh ose permendett e fjalet: SHQIPNI ETNIKE, KOMB E FLAMUR KUQ E ZI.

Kryetari i Balit Kombetar krijoi Ideaiu, per te ciilin vdiqen dhe jane gati te vdesin gjithe Shqiptaret, puntore te Shqip nise.

MIDHAT FRASHERI asht gjithmone i gjalle ne zemrat e Shqiptarvet qe sot e gjithemone kane per t' a vajtue me lotet e zemret.

Asht i gjalle, sepse: **Ai na mesoj me dashi shqipnin etnike. Ai ne mesoj me qene idealista per idealet e shejta te Kombit; Ai na mesoi se shqipnija duhet te jete e shqiptarvet. Ai na çoi perpara ne lufte per shpe timin e shqipnise nga zaptimi dhe nga kumunizmi; dhe me gas seicili kerkoi dhe kerkon vdekjen. Kotë vdekje per te miren e kombit, qe ishte i vetmi qellim i Midhat Frasherit, i takoi edhe Atij heroi. I cili bash ni ata momente qe perpiqesh per te lirua popullin shqiptar u shtri n' atarin e shepte t'Atdheut.**

MIDHAT FRASCHERI me gjithe Shqiptaret qe e duje kishin e drejtin popullin Shqiptar drejt Demokrceivet Anglo-Amerikane. "Komunizmi asht anti-demokratik dhe anti-njerezor tha Midhat Frasheri ne 1943. Kde deklarate i bani aleatvet ne malsinat e Tiranes, athere kur ky luftonte prej lirine e vendit te vet. Kjo profeci iu deklarue Misionit Ushtarak Anglo-Amerikan; dhe ish athere kur shumica e popujvet besonet ne mashtrimin e Rusise Komunistes se në komunizëm egzistonte njerezi dhe Demokraci. Dhe n'anen tjeter Midhat Frashieri qysh ne 1943 thase Populli Shqiptar asht e mbetet Aleat vetem ate mqt e sinqerte Anglo-Amerikanë. Midhat Freshieri ishte i bindun mir drejtsin e popujve Anglo-Saksonë se Shqipnija e njerezeve do t' a shpetojne, Ky besim i Midhat Frasherit mbetet i gjalle ne zemrat e gjithe Shqiptarevet dhe per ma teper i te gjithe bashkpuntorevet te Midhat Frasherit, te ciilet do te ndjekin me bindj r dhe burrni te gjitha parimet e Ky-tyrit te tyne te pavdekshem. Programi Kombetar qe na asht lane amanet nga DJALI I ABDYL FRASHERIT do, ndjelet pik per pikë dhe do te zbatohet ashtu sic i ka hije popullit t' one që del prej nujt vuejtjesh dhe rrebesbesh kombetare.

Thjeshtesija personale qe karakterizonte Midhat Frascherin na mbetet mburrja ma e madhe, e që neser historija Shqiptare do t' a shenoje me fjalet e arta. Me kete thjeshtesi Midhat Frasherin e shfahe ne rreshtat e ushtarevet, e shfshe ne rreshtat e krejt Emgranivet, e kjo na bau t' i thomi vehtes dhe t' i napim fjalen para Flamurit kombetar se s'jemi gja fjet er vrer e sherbetuet e Shqipnise Etnike. Vetem ne ket menyre da mundemi qe te ndjekim vepren gigantesk te Midhat Frascherit. AY jetoi me popullin, sepse ishte i popullit; AY perpalloi te gjitha vuejtjet pa me thane se ishte apo u ndigjoste ndonjehere i lodhun. Plaku i Nacionalizmes nuk e ndigjonte kurr vehten te plakun, perkundrazi Ai s' pranonte te quhesh Plak. Ky parim e kish atrue dhe lidh shpirtmsht me rinine Shqiptare, te ciilen e kish rrit dhe edukue. Te gjitha kujtesjet e Midhat Frasherit ishin per brezin e riuje, ne te ciilin kish besimin ma te plote.

MIDHAT FRASHERI ish pagzue fo vetem per popullin Shqiptar te ciilin u mundonte t' a bashkoj dhe te luftoje per te vetmin qellim, per Shqipnin e Shqiptarevet, por ish pagzuar edhe me kufijaret e Shqip nise te ciilve sa here iu kish drejtue thirrje bashkimmi dhe harmonije. Te gjitha tezat programatike te Midhat Frasherit u rjeshtuene ne Oktollogun e tanishm, i cili ish shkrue nga vete dora e Midhat Frasherit. Ky Octollog shfie driten ne Nandarin e 1942 athere kur Shqipnija kishte ne program bashkimmin e sinqerte me kufijaret e tokes dhe te detit. Fjalet e fundit jane tekstuale te shkruetme nga Kryetari i Nacionalizmit Shqiptare. Dhe ky Octollog asht dokumenti ma i forte per t' i tregue mqvet dhe anmiqve dë shqipnis se Balli Kombetar nen kryesin e Midhat Frasherit ndjekte rrugen e pagzu me te gjithe Shtetet qe duen te respektojne te drejtat reciproke te njeni tjetrit. Sado qe Midhat Frasheri fizikisht mbarojë misionin e Tije te farte sinqket qe ndjekin gjurmet e Midhat Frasherit kane dhe do vazhdojne po me krto qellime.

Te gjithe Antaret e Ballit ne Bagnoli te mbledhun reth Flamurit Kombetar, solidare t' Idealit te Midhat Frasherit betohen se gjurmet e Tija do t' i ndjekin pa u kursye per asnji moment te jetes tyne.

Deshprimi i jone i sotshem do kthehet ne gaz kur Shqipnija Etnike e andrtuesme prej Midhat Frasherit do jete e lirueme, Prandaj dukt pase besim ne krejt antaret e Ballit se sejcili do boje detyren e tij si sherbetor i Shqipnise dhe dhimbja e jone do paksohet vetem athere kur te jete shpëtue SHRIPNIJA E SHQIPTAREVET.

I PERJETSHEM QOFTE KUJTIMI I BABAJT TE SHQIPTARIZMES.

MIDHAT FRASHERIT!

ANTARET E BALLIT KOMBETAR NE BAGNOLI

5 Tetor 1949.

200 persona

Italian newspaper? Kali in Belgrad!

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 5

MEDIA ITEMS #1



AIDSSH

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.